

Gara e Vitit të Ri

Klasa e parë

Detyra 1: Erblina dhe Hristina sëbashku katër orë kanë pasur trajnim për tenis. Sa orë ka pasur trajnim Hristina?

Përgjigje: 4

Detyra 2: Danieli në ëmbëlsirën e ditëlindjes së tij kishte ndezur 5 qirinj njëkohësisht. Një qiri digjet për 7 minuta. Sa minuta duhen që të digjen të gjithë qirinjtë?

Përgjigje: 7

Detyra 3: Nëna e Martinit ka tre djem. Djali më i vogël quhet Dejan, ndërsa djali më i madh Dushko. Sa shkronja ka emri i djalit të mesëm?

Përgjigje: 6

Detyra 4: Në tabelën e dhënë në vizatimin e mëposhtëm janë shënuar disa numra. Sa çifte numrash (dy numra) nga numrat e shënuar kanë shumë 9?

Vërejtje: Çifti (1,8) dhe çifti (8,1) numërohen si një çift.


4	8	2	13
11		3	
5	7	12	1

Përgjigje: 3

Detyra 5: Në brezhin e Vitit të Ri Jana dhe Sanja kishin vendosur 18 llampione. Nëse Jana kishte vendosur 7 llampione, sa llampione kishte vendosur Sanja?


Përgjigje: 11

Detyra 6: Në vizatim janë dhënë gjashtë kapele. Njërës prej tyre i mungon një numër. Cili është ai numër?




Përgjigje: 13

Detyra 7: Në vizatim është dhënë një shtëpi e cila ka dhoma të lidhura njëra me tjetrën me dyer (vijat janë muret, ndërsa hapësirat bosh janë dyert). Breshka Zhelko ndodhet në hyrjen e shtëpisë (e shënuar si hyrje) dhe duhet të arrijë në një të një prej daljeve. Lejohet të lëvizë vetëm nëpër dhoma në formë trekëndëshi, duke kaluar nga një dhomë në tjetrën përmes derës së përbashkët. Në këtë mënyrë mund të arrijë vetëm te një nga daljet. Cili është numri i kësaj daljeje (1 apo 2)?



Përgjigje: 1

Detyra 8: Aneta bënte një zarf nga një fletë letre (si në vizatimin e dhënë majtas) duke i palosur pjesët trekëndore drejt vetes. Cilin nga zarfet e palosura të paraqitur djathtas (1, 2, 3 ose 4) do të fitojë Aneta?



1



2



3




4


Përgjigje: 3

Detyra 9: Në katrorët e secilit vizatim ka lule. Vendosja e saktë e luleve është nëse në katrorin më të vogël ka më shumë lule, ndërsa në atë më të madh ka më pak lule. Në cilin nga vizatimet vendosja nuk është e saktë (1, 2, 3 ose 4)?


1




2



3




4



Përgjigje: 3

Detyra 10: Numëro sa trekëndështa të ndryshëm ka në vizatim? Trekëndëshat mund të mbivendosen.



Përgjigje: 8

Klasa e dytë

Detyra 1: Sa herë gjithsej shfaqet shifra 2 në numrat e dhënë?

2021 2022 2023 2024 2025
2026 2027 2028 2029 2030
21 72

Përgjigje: 22

Detyra 2: Në tabelën e dhënë në vizatimin e mëposhtëm janë shënuar disa numra. Sa çifte numrash (dy numra) nga numrat e shënuar kanë shumë 42?

Vërejtje: Çifti (19, 23) dhe çifti (23,19) numërohen si një çift.



Përgjigje: 5

Detyra 3: Kryej operacionet e kërkuara dhe shkruaje numrin e përfutur në hapësirën bosh.


6	-	4	+	7	+	3	+	5	-	2	-	8	+	1
---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Përgjigje: 8

Detyra 4: Bredhi i Vitit të Ri i Janës është 25 cm më i shkurtër se ai i Manes. Nëse bredhi i Manes është 142 cm i lartë, sa cm është i lartë bredhi i Janës?


Përgjigje: 117

Detyra 5: Në vizatim janë dhënë gjashtë kapele. Njëres prej tyre i mungon një numër. Cili është ai numër?




Përgjigje: 47

Detyra 6: Në vizatim është dhënë një shtëpi e cila ka dhoma të lidhura njëra me tjetrën me dyer (vijat janë muret, ndërsa hapësirat bosh janë dyert). Breshka Zhelko ndodhet në hyrjen e shtëpisë (e shënuar si hyrje) dhe duhet të arrijë në njërin prej daljeve. Lejohet të lëvizë vetëm nëpër dhoma në formë trekëndëshi dhe në këtë mënyrë mund të arrijë vetëm te një nga daljet. Nëpër sa dhoma do të kalojë Zhelko për të arritur në daljen (pa u kthyer në dhomën ku ka qenë)?



Përgjigje: 8

Detyra 7: Joana bënte një zarf nga një fletë letre (si në vizatimin e dhënë majtas) duke i palosur pjesët trekëndore drejt vetes. Cilin nga zarfet e palosura të paraqitur djathtas (1, 2, 3 ose 4) do të fitojë Joana?



1



2




3




4

Përgjigje: 2


Detyra 8: Në vizatimin më poshtë janë dhënë figura nga të cilat një pjesë është e ngjyrosur. Në cilat figura nuk është ngjyrosur saktësisht gjysma e figurës?



1



2



3



4

Përgjigje: 3

Detyra 9: Në vizatim është dhënë një formë 3D (në pjesën e sipërme). Cila nga format e mëposhtme (1, 2, 3 ose 4) përputhet me formën e sipërme?



1



2



3



4

Përgjigje: 1

Detyra 10: Sara çdo ditë nga e hëna deri të premten zgjidh një detyrë në ditë, ndërsa të shtunën dhe të dielën zgjidh dy detyra në ditë. Sa detyra ka zgjidhur Sara gjatë një jave?

Përgjigje: 9

Klasa e tretë

Detyra 1: Në një fabrikë për dekorime të Krishtlindjeve prodhohen 30 lampione për një minutë. Sa lampione do të prodhohen për katër minuta?

Përgjigje: 120


Detyra 2: Të tre nxënësit Bojani, Siari dhe Iliri së bashku kanë 38 vjet. Sa vjet kishin së bashku para 3 vjetësh?

Përgjigje: 29

Detyra 3: Zana hyri në ashensor. Ajo së pari zbriti 4 kate poshtë, pastaj u ngjit 5 kate lart dhe përfundimisht zbriti 6 kate poshtë. Kur doli nga ashensori, ajo ishte në katin e tretë. Në cilin kat hyri Zana në ashensor?


Përgjigje: 8

Detyra 4: Në vizatim janë dhënë gjashtë kapele. Disa prej tyre u mungon numri. Cila është shuma e numrave të cilët mungojnë?




Përgjigje: 64

Detyra 5: Në vizatim është dhënë një formë 3D (në pjesën e sipërme). Cila nga format e mëposhtme (1, 2, 3 ose 4) përputhet me formën e sipërme?




Përgjigje: 3

Detyra 6: Marija bënte një zarf nga një fletë letre (si në vizatimin e dhënë majtas) duke i palosur pjesët trekëndore drejt vetes. Cilin nga zarfet e palosura të paraqitur djathtas (1, 2, 3, 4, 5 ose 6) do të fitojë Marija?



Përgjigje: 3

Detyra 7: Numëro sa katërkëndësha të ndryshëm ka në vizatim? Katërkëndëshat mund të mbivendosen.




Përgjigje: 6

Detyra 8: Babadimri ndan paketa për Vitin e Ri. Në rrugën "Fëmijë të mirë", ai i dha secilit nga 15 fëmijët nga dy paketa, ndërsa në rrugën "Fëmijë të këqinj" i dha secilit fëmijë nga një paketë. Nëse Babadimri ndau gjithsej 41 paketa në këto dy rrugë, sa fëmijë jetojnë në rrugën "Fëmijë të këqinj"?

Përgjigje: 11

Detyra 9: Në vizatimin e mëposhtëm janë dhënë figura nga të cilat një pjesë është e ngjyrosur. Tek cilat figura nuk është ngjyrosur saktësisht gjysma?



Përgjigje: 3

Detyra 10: Në vizatimin e dhënë, katrorët janë plotësuar me shkronja nga alfabeti i gjuhës shqipe. Në sa vende ndodhet fjala MATEMATIKA, duke pasur parasysh se është e lejuar që të lexohet në të gjitha tetë drejtimet (lart, poshtë, majtas, djathtas dhe në mënyrë diagonale)?

Vërejtje: Në shembullin e dhënë (shiko figurën në të majtë) janë shpjeguar tetë drejtimet.

M	A	S	A	R	T
G	A	L	E	B	M
A	A	S	A	M	A
S	A	S	A	M	S
A	A	S	A	Z	A
M	A	V	I	M	P

A	M	Ç	N	P	ZH	U	G	M	M
R	A	F	E	S	I	E	P	A	ZH
SH	T	I	J	L	K	I	T	T	A
Z	E	Z	K	S	G	E	K	I	J
Q	M	I	E	O	M	O	U	M	I
A	A	K	L	A	U	S	GJ	A	M
XH	T	A	T	O	NJ	U	A	T	E
A	I	I	L	P	E	M	E	I	H
B	K	V	U	C	P	O	D	K	S
A	A	S	O	E	S	P	O	A	L

Përgjigje: 2